



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Njesia org. Org.Jedinica Org.Unit	51-02
Nr. i Fajteve Br. Stranica No. Pages	-04-
Nr. i Prot. Broj Prot. Prot. No.	6842-2/24
Data: Datum: Date:	30.01.25
PRISHTINË / A	
No. 1	

DATË/A:	13.01.2024
REFERENC-Ë:	23/6842/MMPHI
PËR/ZA/TO:	"Agi-Dani" Sh.p.k. Gjilan, Shfrytëzim i gurit gëlqeror, Koretishtë dhe Strazhë, Novobërdë.
CC:	Komisioni për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi, U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për Leje Mjedisore

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ka shqyrtuar kërkesën për tu pajisur me vazhdimin e Lejes Mjedisore të operatorit "Agi-Dani" Sh.p.k. Gjilan, me nr.prot.23/6842/MMPHI, për veprimtarin:Thërmim dhe seperim i gurit gëlqeror-Koretishtë, Komuna e Novo Bërdës.

MMPHI, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, një sërë takimesh dhe vizitës në teren, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur:

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.: 23/6842/MMPHI
Datë: 13.01.2024

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), Rregullores (QRK) Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, paragrafi 1, 2 dhe 4 të nenit 12 dhe nenit 13 dhe nenit 9 paragrafi 1.4 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Operatori "Agi-Dani" Sh.p.k. Gjilan, me nr. prot. 23/6842/MMPHI, pajiset me **Leje Mjedisore**, për veprimtarinë: Shfrytëzim i gurit gëlqeror, në ngastrën, P-72403034-00205-1, P-72403034-00212-0 dhe P-72403058-03948-1, nr. lëndës: 598/2018, në sipërfaqe prej 41500.1m², zona kadastrale Koretishtë dhe Strazhë K. Novobërdë, sipas Pëlqimit Mjedisor i MMPHI-së dhe Licencës së Shfrytëzimit të KPMM-së.
2. Operatori obligohet:
 - 2.1. Të bënë monitorimin e vazhdueshëm të pajisjeve, respektivisht përmbushjes së kërkesave teknike;
 - 2.2. Sistemi de- pluhurues të jetë funksional, gjatë transportit të gurit gëlqeror;
 - 2.3. Për sistemin menaxhues mjedisore të këtë personin e profilit të mjedisit që është përgjegjës për mjedis;

Faqe 2 nga 4



- 2.4. Pas përfundimit të aktivitetit të bëhet rehabilitimi i terrenit sipas përshkrimit në aplikacion;
- 2.5. Nëse gjatë operimit do të ketë ndonjë prishje teknike e që mund të ketë ndikim në mjedis dhe shëndetin e popullatës, të njoftoj MMPHI;
- 2.6. Të mirëmbahet në vazhdim sipërfaqja e rrethojës operuese.

A r s y e t i m

Pas shqyrtimit të kërkesës për vazhdimin e Lejes Mjedisore për operatorin është konstatuar se, "Agi-Dani" Sh.p.k. Gjilan, Thërrmim dhe seperim i gurit gëlqeror, në ngastrën, P-72403034-00205-1, P-72403034-00212-0 dhe P-72403058-03948-1, nr. lëndës: 598/2018, në sipërfaqe prej 41500.1m², zona kadastrale Koretishtë dhe Strazhë K. Novobërdë, plotëson kriteret e parapara me Udhëzim Administrativ 04/2022/MMPHI, për Leje Mjedisore.

Operatori ka bashkangjitur dokumentet:

- Aplikacionin e plotësuar në pesë kopje fizike dhe një kopje elektronike (CD);
- Fletëpagesën, në bazë të Vendimit: Nr. 13/99, te dt. 30.09.2022, për përcaktimin e kriterëve dhe vlerat e tarifës për shërbimet lidhur me procedurat e shqyrtimit të kërkesave për leje mjedisore;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit;
- Pëlqim Mjedisor me Nr. 18/2001/1-ZSP/144/17, të lëshuar me dt. 21.05.2018;
- Leje për aktivitetet e veçanta për sortues me Nr.1903/KPMM/2019, me afat të vlefshmërisë deri me 04.07.2027;
- Njoftim nga Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, të Komunës së Novobërdës të shfrytëzimit të pronës, me nr.13/2017, të datës 12.07.2017.
- ANEX- Kontraten nga APK-ja, Ref.:DE-406/24, data e lëshimit: 29.03.2024 me afat vlefshmërisë gjerë me :14.12.2028.

Operatori i ka sjellë të gjithë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me Udhëzimin Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, gjithashtu operatori i ka plotësuar të gjitha kushtet teknike dhe mjedisore.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, vlerëson se operatori i plotëson kushtet teknike dhe mjedisore dhe merr Vendim për **Lëshimin e Lejes Mjedisore**.

Kjo Leje Mjedisore lëshohet për periudhën 5 (pesë) vjeçare, në përputhje me nenin 31 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtje e Mjedisit dhe nenit 12 paragrafi 4 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore



Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Izedin Bytyqi

U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së

Vendimi i dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës- Novobërdë;
- DMMU-së;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së